

KONTRATE THEMELIMI
e
Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
"FERAR" Sh.P.K.



Palet qe firmosin me poshte:

Arjan Çukaj, i biri i Qerimit dhe i hamides, i datelindjes 1969, lindur ne Sarande, banues ne Tirane, Rr. "Karl Topia" P. 2 Sh. 3 Ap. 4 me arsim inxhinier ndertimi

dhe

Ferid Sukaj, i biri i Isufit dhe i Vjollces, i datelindjes 1968, lindur ne Kavaje, banues ne Tirane, Rr. "Karl Topia" P. 2 Sh.3 Ap. 4 me profesion arkitekt

u moren vesh per sa me poshte vijon:

Neni 1

Te nenshkruejne kontraten e themelimit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, pasi jane marre vesh ta themelojne ate ndermjet tyre.

Neni 2

Shoqeria vepron ne baze te dispozitave te legjisacionit shqiptar ne fuqi, te kesaj kontrate dhe te statutit qe i bashkangjitet kesaj kontrate.

Neni 3

Emertimi i shoqerise eshte "FERAR" Sh.P.K.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

- *Projektimi dhe zbatimi i veprave civile industriale, turistike, buqesore etj. dhe kompletimet e nevojshme per to.*
- *Punime te shtresave te rrugeve dhe ndertimin e ujesjellesave, kanalizimeve, impianteve vadites.*
- *Punime restaurimi, murature, betoni, barmeje te zakonshme*
- *Punime shembjeje, punime dhei*

Shoqeria gjithashtu ka te drejte te kryeje veprimtari administrative, financiare, bankare etj. qe lidhen me objektin kryesor te saj dhe qe gjykohen te nevojshme apo te dobishme prej saj.

Neni 5

Selia e shoqerise ndodhet ne Rr. "Karl Topia" P. 2 Sh. 3 Ap. 4, Tirane, Shqiperi.



Neni 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare ne 20 pjesa, plotesisht te shlyera me vlore 5.000 leke secila.

Neni 8

Secili prej ortakeve ka derdhur shumen korresponduese te pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkuara. Shumat e derdhura depozitohen prej tyre ne nje banke te Shqiperise ne nje llogari te hapur ne emer te shoqerise.

Shuma e depozituar vertetohet me anen e nje certifikate te leshuar nga ajo banke, ne te cilen shenohen emrat, mbiemrat e ortakeve, pjeset e kapitalit themeltar te nenshkuara dhe shuma e derdhur nga secili prej tyre.

Neni 9

Shoqeria do te administrohet nga nje Drejtor Ekzekutiv. Si Drejtor Ekzekutiv emerohet Arjan Çukaj, te cilil i jepen te gjitha kompetencat, te cilat ai i pranon, per te kryer formalitetet e themelimit te parashikuara nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Ai eshte i autorizuar te veproje ne emer te shoqerise qe krijohet per regjistrimin e saj. Pasi te behet regjistrimi i shoqerise, keto akte dhe angazhime i nenshtrohen miratimit te bashkesise se ortakeve jo me vone se sa nga data e mbledhjes se pare te Asamblese se Ortakeve qe shqyrton dhe vendos mbi llogarite e vtit te pare finanziar. Ky miratim ben automatikisht kalimin e ketyre akteve dhe angazhimive ne ngarkim te shoqerise.

Neni 10

Kjo kontrate themeluese eshte hartuar ne Tirane, Shqiperi ne 4 ekzemplare originale, duke patur te gjitha tekstet fuqi te barabarte ligjore.

Arjan Çukaj

Ferid Sukaj



STATUT

i

Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "FERAR" Sh.P.K.

Palet qe firmosin me poshte:

Arjan Çukaj, i biri i Qerimit dhe i hamides, i datelindjes 1969, lindur ne Sarande, banues ne Tirane, Rr. "Karl Topia" P. 2 Sh. 3 Ap. 4 me arsim inxhinier ndertimi

dhe

Ferid Sukaj, i biri i Isufit dhe i Vjollces, i datelindjes 1968, lindur ne Kavaje, banues ne Tirane, Rr. "Karl Topia" P. 2 Sh.3 Ap. 4 me profesion arkitekt

kane hartuar, si me poshte vijon, statutin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, te cilen jane marre vesh ta themelojne ndermjet tyre, sipas kontrates se themelimit.

KREU I

Forma, Emertimi i Shoqerise, Objekti, Selia, Kohezgjatja

Neni 1

Forma

Ndermjet nenshkruesve te kontrates se themelimit eshte krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, kontraten e themelimit dhe me dispozitat e ketij statuti.

Neni 2

Emertimi i shoqerise

Emri i shoqerise eshte "FERAR" Sh.P.K.

Neni 3

Objekti

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

- *Projektimi dhe zbatimi i veprave civile industriale, turistike, bujqesore etj. dhe kompletimet e nevojshme per to.*
- *Punime te shtresave te rrugeve dhe ndertimin e ujesjellesave, kanalizimeve, impianteve vadites.*
- *Punime restaurimi, murature, betoni, barmeje te zakonshme*
- *Punime shembjeje, punime dhei*

Shoqeria gjithashtu ka te drejte te kryeje veprimtari administrative, financiare, bankare etj. qe lidhen me objektin kryesor te saj dhe qe gjykohen te nevojshme apo te dobishme prej saj.



Neni 4
Personaliteti juridik

Shoqeria njihet si person juridik dhe fillon veprimtarine e saj pas regjistrimit te saj ne organet kompetente shteterore shqiptare.

Neni 5
Selia e shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne Rr. "Karl Topia" P. 2 Sh. 3 Ap. 4, Tirane, Shqiperi. Transferimi i selise se shoqerise ne nje adresë tjeter behet me miratimin unanim te ortakeve. Vendbanimi i ortakeve lidhur me raportet e tyre me shoqerine eshte ai qe rezulton ne regjistrin tregtar.

Neni 6
Çelja e filialeve, degeve dhe perfaqesive

Shoqeria mund te çele filiale, dege dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe ne shtete te tjera. Njesite strukturore te shoqerise, filialat, deget dhe perfaqesite e saj krijohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ate te vendeve ku do te ngrihen.

Neni 7
Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte peraktuar deri ne vitin 2004. Kjo periudhe mund te zgjatet tej afatit te mesiperm me miratimin e ortakeve.

KREU II

Kapitali themeltar, Kontributet, Pjeset e Kapitalit Themeltar

Neni 8
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Ai eshte i ndare ne 20 pjesa me vlore 5.000 leke secila plotesisht te shlyera.

Neni 9
Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit

Ortaket nuk kufizohen ne rritjen e kapitalit themeltar. Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet

shtimit te pjeseve te reja, ortaket kane te drejten e perparese ne neshkrim, proporcionalisht me shumen e pjeseve te tyre. Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj. Zvogelimi i kapitalit vendoset nga Asamblea e Ortakeve me miratimin unanim te Asamblese. Zvogelimi i kapitalit i prek te gjithe ortaket ne te njejten mase.

Neni 10 Kapitali themelor

Kapitali themelor i shoqerise eshte 100.000 leke i cili perbehet nga:

1. Kontributi ne para i z. Arjan Çukaj me 50.000 leke
 2. Kontributi ne para i z. Ferid Sukaj me 50.000 leke
- Ortaket nuk kane kontribut ne natyre.

Neni 11 Pjeset e kapitalit themeltar

Ne baze te kontributeve te lartpermendura:

Arjan Çukaj merr 10 pjesa te kapitalit themeltar (ose 50 %) per kontributin e tij.

Ferid Sukaj merr 10 pjesa te kapitalit themeltar (ose 50 %) per kontributin e tij.

Te gjitha pjeset qe formojne kapitalin themeltar nenshruhen, shlyhen plotesisht dhe shperndahen ndermjet ortakeve sipas ndarjes se mesiperme.

Neni 12 Lenia dhe transferimi i pjeseve te kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve dhe me rruge trashegimie, ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve, ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve. Ne rast se nje ortak deshiron te shese pjesa te pjesemarrjes se tij ne kapitalin themeltar te shoqerise, ai duhet te njoftoje Asamblene e Ortakeve me ane te nje letre rekomande, numrin e pjeseve qe deshiron te shese dhe çmimin e çdo pjesa. Ortaku tjeter, pasi ta kete marre njoftimin nga Drejtori Ekzekutiv, mund te pranoje blerjen ose heqjen dore prej saj duke njoftuar me shkrim Drejtorin Ekzekutiv brenda 30 ditesh. Pasi shitja te jete kryer, ortaku duhet t'i komunikonte Drejtorit Ekzekutiv identitetin e njerit ose disa ortakeve te rinj, te cilet duhet te gezojne zotesi te plote juridike.

KREU III

Te Drejtat dhe Detyrat e Ortakeve

Neni 13 Te drejtat

Ortaket gezojne keto te drejta kryesore:

- Drejtimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me kontraten e themelimit dhe kete statut;
- Pjesemarrjen ne rezultatet e çdo forme e sasie te veprimtarise se shoqerise;
- Emerimin e Drejtorit Ekzekutiv per administrimin e shoqerise;

- Marrjen e te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomiko-tregtare dhe me veprimtarine e shoqerise, si dhe me dokumentet e perpunuara nga shoqeria, si bilancet dhe llogaritje ekonomike;
- Paraqitjen e kerkesave, verejtjeve e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Asamblea e Ortakeve, sipas ketij statut;
- Transferimin e pjeseve te kapitalit ndermjet tyre ose personave te trete;
- Marrjen ose dhenien e huase.



Neni 14

Detyrat e ortakeve

Ortaket kane keto detyra kryesore:

- Te derdhin kontributet e tyre per formimin e kapitalit themelor;
- Te marrin pjese ne drejtimin e shoqerise si dhe ne administrimin e saj, sipas ketij statut;
- Ti jalin shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e çdo objektivi lidhur me veprimtarine e saj;
- Te kryejne detyrat per realizimin e objektit dhe te funksioneve te shoqerise.

KREU IV

Marrja e Vendimeve, Administrimi dhe Kontrolli i Shoqerise

Neni 15

Ortaket dhe Asamblea e Ortakeve

Ortaket e shoqerise perballojne humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar. Vendimet merren nga Asamblea. Çdo ortak merr pjese ne vendimet e Asamblese dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Me ushtrimin e te drejtis se tyre per te marre pjese ne vendimet e Asamblese çdo ortak ka te drejte te perfaqesohet nga nje ortak tjeter, nga bashkeshorti ose nga nje person tjeter i zgjedhur ose i autorizuar me shkrim prej tij.

Neni 16

Mbledhja e Asamblese

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga nje ose nga te dy ortaket qe zoterojne 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar, nga Drejtori Ekzekutiv, nga ekspertet kontabel te autorizuar ose nga likuiduesit.

Sipas rendesise se vendimeve, mbledhja e Asamblese mund te jete e zakonshme ose e jashtezakonshme. Asambleja e zakonshme vendos per çeshtje te tilla si: emerimi ose shkarkimi i Drejtori Ekzekutiv, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive vjetore dhe ndarjes se fitimit, etj. Asamblea e jashtezakonshme vendos per çeshtje te tilla si: ndryshimet e statutit, zvogelimi i kapitalit themeltar, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, zgjatja e kohes se veprimtarise se shoqerise apo likuidimi i saj, shnderrimi i shoqerise me perjegjesi te kufizuar ne shoqeri te formave te tjera, transformimi i administrimit te shoqerise nga nje Administrator i vetem ne nje Keshill Administrativ etj.

Asamblea e zakonshme ne mbledhjen e pare mund te marre vendime te vlefshme me unanimitet. Ne qofte se mbledhja e pare e Asamblese se zakonshme nuk realizohet, thirret mbledhja e dyte, e cila mund te marre vendime te vlefshme, pavaresisht se sa pjese te kapitalit themeltar zoterojne ortaket e pranishem ose te perfaquesuar. Asamblea e jashtezakonshme kerkon kushte prezence ose perfaqesimi te njejtë me ato te

Asamblese se zakonshme. Vendimet e Asamblese perbehen nga nota me shkrim te firmosura nga sekretaria dhe nga nje ortak i caktuar nga Asamblea.

Neni 17
Administrimi

Shoqeria administrohet nga nje Drejtor Ekzekutiv, i cili eshte Arjan Çukaj. Emerimi i Drejtorit Ekzekutiv behet per nje kohezgjatje prej 3 vjetesh financiare, me te drejt riperteritjeje, me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose te shkarkimit te parakohshem. Drejtori Ekzekutiv eshte perqieges ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve per shkelje ligjore, per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij.

Neni 18
Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv ka ne kompetence:

- Administrimi i zakonshem i shoqerise, me perjashtim te kompetencave taksative te Asamblese se Ortakeve;
- Miratimi i planeve dhe llogarive ekonomike periodike;
- Propozimi i ndryshimit te kapitalit;
- Percaktimi i regjimit dhe kushteve te llogarise ekonomike;
- Miratimi i rregullave te brendshme te shoqerise dhe te personelit;
- Miratimi i organikes se personelit;
- Paraqitura e propozimeve Asamblese se Ortakeve per perdonimin e fondevet, shperndarjen e fitimeve dhe likuidimin e borxheve;
- Miratimi i njesive te reja strukturore, filiale, dege;

Drejtori Ekzekutiv ngarkohet per te kryer te gjitha veprimet juridike me te tretet ne emer te shoqerise. Ai ben komunikimin e mbledhjeve te Asamblese se Ortakeve dhe merr masa per krijimin e kushteve per zhvillimin normal te saj, si dhe shlyen shpenzimet per arsyet pune. Administrimi i veprimitarise se perditshme operative te shoqerise behet nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 19
Ekspertet kontabel te autorizuar

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhjeje nga shumica e ortakeve qe zoterojne mbi 1/2 e kapitalit themeltar. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kondita si emerimi, ne rast se kryhen shkelje, verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres.

KREU V

Viti finanziar, Llogarite Vjetore, Ndarja e Fitimeve, Rezerva e Domosdoshme

Neni 20
Viti finanziar, llogarite vjetore

Cdo vit finanziar fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar do te

perfundoje me 31 dhjetor 1994. Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e veçanta te hartuara nga Drejtori Ekzekutiv dhe nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Asamblea me unanimitet.

Miratimi i dokumenteve mbi veprinatarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit finanziar.



Neni 21
Dividentet

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, Asamblea e Ortakeve percakton pjesen qe u takon ortakeve ne formen e dividenteve mbi fitimin. Fitimi ndahet ndermjet ortakeve ne proporcione pjeset e kapitalit themeltar. Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit finanziar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem si dhe i jane zbritur ose i jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme.

Neni 22
Rezervat e domosdoshme

Shoqeria, nga fitimi i realizuar gjate vitit finanziar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e vitit te meparshhem, rezervon nje shume me vlere te pakten 1/20 te tij, e cila destinohet per formimin e fondit rezerve te domosdoshem.

KREU VI

Zgjatja e Afatit, Prishja dhe Likuidimi

Neni 23
Zgjatja e afatit

Me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 7 te ketij statuti, zgjatja e tij mund te vendoset nga Asamblea me unanimitet.

Neni 24
Prishja

Shoqeria prishet me perfundimin e afatit te percaktuar ne nenin 7 te ketij statuti, me perjashtim te rasteve kur behet zgjatja e afatit sipas nenit 23 te ketij statuti, ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsyet e parashikuara me ligj. Shoqeria nuk prishet kur njeri prej ortakeve falimenton, behet i paafste ose vdes.

Neni 25
Likuidimi

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asamblea emeron nje ose disa likuidues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit

te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likuidimit, Asamblea vendos per bilancin finanziar perfundimtar, per aktin e rregullshmerise se punes se likuiduesit e per heqjen e mandatit te tij si likuiduesi dhe per mbylljen e procesit te likuidimit. Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakeve ne perpjestim te njejtë me kontributin qe zoterojne ne kapitalin themeltar.

KREU VII

Dispozita te Fundit

Neni 26

Shnderrimi i shoqerise

Shnderrimi i shoqerise me perjegjesi te kufizuar ne shoqeri kolektive ose komandite behet me miratimin unanim te ortakeve. Shnderrimi i shoqerise me perjegjesi te kufizuar ne shoqeri anonime behet me unanimitet, vetem pasi shoqeria te kete hartuar dhe te kete miratuar nga ortaket bilancin e dy viteve te fundit te veprimtarise se saj. Vendimi merret pasi te paraqiten raporti mbi gjendjen e shoqerise nga ana e nje eksperti per shnderrimin.

Neni 27

Mosmarreveshjet

Te gjitha mosmarreveshjet ndermjet ortakeve si dhe ndermjet shoqerise dhe ortakeve qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit te saj, do ti paraqiten per zgjidhje Gjykata e Rrethit Tirane.

Neni 28

Ceshtjet qe nuk trajtohen ne kete statut rregullohen sipas legjisacionit perkates shqiptar.


Neni 29

Ky statut eshte hartuar ne Tirane ne 4 ekzemplare originale, duke patur te gjitha tekstet fuqi te barabarte ligjore.

Arjan Çukaj



Ferid Sukaj



Tirane, me _____

